

VENDIM
Nr. 74, datë 3.2.2017

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, ME NR. PASURIE 7/160, NË ZONËN KADASTRALE
8270, QË PREKET NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “RIKONSTRUKSIONI DHE NDRYSHIMI
I DESTINACIONIT TË ISH-LABORATORIT HIDRAULIK NË QENDËR ARTI – SKENA E
RE”, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 2, DATË 9.9.2015, TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË
TERRITORIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga zbatimi i projektit “Rikonstruksioni dhe ndryshimi i destinacionit të ish-laboratorit hidraulik në qendër arti – skena e re”, miratuar me vendimin nr.2, datë 9.9.2015, të Këshillit Kombëtar të Territorit.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Kulturës.
 3. Pronari i pasurisë së paluajtshme me nr.pasurie 7/160, në zonën kadastrale 8270, që shpronësohet, z. Sotir Tasho, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse për pasurinë truall, me sipërfaqe 65 (gjashtëdhjetë e pesë) m², me një vlerë të përgjithshme prej 4 352 985 (katër milionë e treqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 4 352 985 (katër milionë e treqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë) lekësh, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.
 5. Shpronësimi të fillojë në datën 9.2.2017.
 6. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Ministria e Kulturës.
 7. Pronari i konfirmuar nga ZVRPP-ja të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Ministrisë së Kulturës.
 8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar nga Ministria e Kulturës, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në emër të Republikës së Shqipërisë dhe me shënimin në përdorim të Ministrisë së Kulturës.
 9. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Financave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

TABELA E PRONARËVE QË PREKEN NGA SHPRONËSIMI

Lista e pronarëve	Pasuria private e cila preket për shkak të shpronësimit	Vlera e truallit sipas VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016	Prona sipas ZRPP-së Tiranë
Sotir Tasho	Sip. trualli : 65 m ² Nr. pasurie: 7/160 Zona kadastrale: 8270 Lloji i pronës: Truall:	4,352,985 lekë	Konfirmuar